

DHOMA AMERIKANE E TREGETISE



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE

LETRA E DHOMËS AMERIKANE TË TREGTISË

PËR PAKETËN FISKALE 2015

Në vijim: Komentet teknike -- dërguar më 7 nëntor 2014 (fq 3)
 Propozimet mbi Paketën Fiskale 2015 -- dërguar më 8 shtator 2014 (fq 12)

Dhoma Amerikane e Tregtisë vlerëson thirrjen e organizatave të biznesit nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat për diskutimin e Paketës Fiskale 2015.

Ashtu sikurse përcaktohet dhe në ligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar”, është një detyrim ligjor konsultimi i legjislacionit tatimor me grupet e interesit, të cilëve u lihet një afat 60 ditor për komente dhe sugjerime për çdo projekt-akt.

Në këtë kuadër, Dhoma Amerikane e Tregtisë kërkon t’ju vërë në dukje faktin se është dërguar Paketa e plotë me të gjitha aktet vetëm 72 orë para se të shkohet në Komisionin e Ekonomisë dhe nuk lë kohën e nevojshme për konsultim me grupet e interesit brenda afatit.

Megjithatë, nga ana jonë janë bërë përpjekjet maksimale për marrjen e komenteve mbi draftet e reja nga ana e anëtarëve në një kohë shumë të shkurtër. Gjatë shqyrtimit të akteve të reja dhe ndryshimeve që ofron Paketa Fiskale, vumë re se nuk janë reflektuar sugjerimet e anëtarëve të AmCham-it dërguar më 8 shtator 2014 (letrën e të cilave e gjeni bashkëngjitur), që ndikonin në përmirësimin e legjislacionit fiskal, uljen e evazionit dhe përmirësimin e ekonomisë.

Nga 14 çështje që ne kemi kërkuar ndryshime dhe kemi dhënë sugjerimet tona, janë marrë parasysh vetëm dy prej tyre, që lidhen me krijimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor, si drejtori e veçantë brenda Ministrisë së Financave si dhe pjesërisht në lidhje me metodën e aplikuar për normat e amortizimit të aktiveve afatgjata.

Ne konsiderojmë se Paketa Fiskale e propozuar në tërësinë e masave të marra rëndon tatimpaguesit e rregullt dhe nuk ndihmon në formalizimin e ekonomisë apo uljen e evazionit fiskal. Ju lutem, gjeni si më poshtë disa nga argumentet tona kryesore:

— Është rritur niveli i taksimit duke mos marrë parasysh nivelet e taksimit në vendet fqinje dhe në rajon. Këtu, kemi parasysh tatimin e mbajtur ne burim mbi të ardhurat nga dividendi, interesat, qiratë, e drejta e autorit etj., qoftë kur janë të ardhura personale të individëve apo të personave juridikë jo-rezidentë.

Rritja e këtyre tatimeve do të ndikojë direkt në investimet e huaja dhe tek kompanitë korrekte, që operojnë dhe paguajnë rregullisht taksat në Shqipëri. Pjesa më e madhe e bizneseve nuk ndikohet nga

kjo rritje sepse as nuk deklarojnë në mënyrë të rregullt dhe as paguajnë detyrimet sipas ligjit. Në këtë mënyrë, nuk do ketë efekt tek buxheti i shtetit, por vetëm një rritje të barrës tek kompanitë e rregullta.

Me rritjen e këtyre tatimeve, ekziston rreziku që bizneset të zhvendosin aktivitetin e tyre në vende të ndryshme të rajonit, ku norma e taksimit është më e ulët dhe dekurajon ardhjen e investimeve të huaja.

Është me rëndësi të kujtojmë se taksa mbi dividendin nuk ka ndryshuar dhe ka mbetur niveli historik prej 10% përgjatë këtyre 18 viteve në Shqipëri, madje edhe gjatë kohës kur tatimi mbi fitimin ishte 30%. Për këtë arsye, ne kërkojmë që JO, nuk duhet të pranohet kjo pjesë e ndryshimeve e paketës fiskale.

- Është ulur niveli i gjobave, por vetëm për subjektet e biznesit të vogël dhe OJF-të, ndërkohë që nuk janë prekur gjobat për tatimpaguesit që janë subjekt i tatimit mbi fitimin; në një rast është zëvendësuar gjoba në shumë fikse me konfiskimin e mallit. Vendosja e gjobave në nivele të larta është një masë, e cila nuk ka çuar në uljen e informalitetit, përkundrazi rrit abuzivitetin nga ana e organeve tatimore dhe nuk prek formalizimin e ekonomisë. Kjo, sepse në asnjë rast nuk bëhet përgjegjës asnjë person në rastet e vendosjes së gjobave të gabuara.
- Kundërshtojmë si të papranueshme shenjën e barazimit, që vendoset ndërmjet rivlerësimit tatimor me rimbursimin e tatimeve të paguara me tepër, duke përcaktuar të njëjtin afat parashkrimi 5-vjeçar në të dyja rastet, sikurse edhe është përcaktuar në Ligjin për Procedurat Tatimore.
- Ndryshimet që janë bërë në lidhje me rimbursimin e TVSH-së nuk garantojnë të drejtën e tatimpaguesit që të mos paguajë detyrime të tjera tatimore, nëse rimbursimi i TVSH-së nuk kryhet brenda afatit ligjor. Duhet të shprehet qartë në ligj se, pavarësisht nëse është miratuar TVSH-ja e rimbursueshme nga administrata tatimore, me skadimin e afatit për rimbursim, tatimpaguesi nuk paguan detyrimet e tjera tatimore deri në shumën e TVSH-së së kërkuar për rimbursim.
- Ndryshimet në ligjin për taksat kombëtare kanë rritur në mënyrë të konsiderueshme barrën financiare të bizneseve të industrisë, në një kohë kur as BE-ja dhe as vendet fqinje nuk aplikojnë taksa indirekte mbi lëndët djegëse që përdoren nga industria. Do të sugjerim që përdorimi teknologjik i lëndëve djegëse (qoftë të ngurta apo të lëngshme) në industri të trajtohet në mënyrë të veçantë nga qeveria, me synim zhvillimin e industrisë vendase dhe bërjen e produkteve tona konkurruese në eksport.

Ne ende nuk kemi informacion në lidhje me efektin që sollën mbi biznesin dhe efektin në buxhet ndryshimet që erdhën me Paketën Fiskale të vitit 2014. Ne vërejmë gjithashtu se sugjerimet dhe komentet tona për Paketën Fiskale 2014 nuk janë marrë parasysh as në Paketën e re për vitin 2015.

Bashkëngjitur kësaj letre do të gjeni gjithashtu të gjitha komentet teknike që vijnë nga Dhoma Amerikane e Tregtisë, për të gjitha projekt-aktet e paketës, ku mendohet se ka vend për ndryshime.

Në pritje të një reflektimi të kërkesave.

KOMENTET TEKNIKE PËR PAKETËN FISKALE 2015

Dërguar më 7 nëntor 2014

1. Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Kundërshtohet shenja e barazimit që vendoset ndërmjet rivlerësimit tatimor me rimbursimin e tatimeve të paguara tepër. Së pari, dhe nga relacioni kuptohet që vendin kryesor në këtë rregullim e zë TVSH-ja, dhe duke patur parasysh se si Direktiva Europiane ashtu dhe ligji për TVSH-në nuk parashikon një kufizim të tillë, kjo nuk mund të përfshihet në një ligj të përgjithshëm, siç është ky i procedurave tatimore.

Nga ana tjetër, ka tatime të tjera të cilat mbarten vit pas viti duke e nxjerrë gjithnjë tatimpaguesin në teprica kreditorë, për shembull tatimpaguesit në fund të vitit parapaguajnë tatimin në burim, me qëllim njohjen e shpenzimit si të zbritshëm, pastaj aplikojnë për zbatimin e marrëveshjeve, duke e mbartur vit pas viti. Apo rasti tjetër, kur parapaguhet tatim mbi fitimin dhe shoqëritë rezultojnë prej shumë vitesh në tepricë kreditorë. Është e pallogjikshme që këto detyrime të evidentuara dhe të njohura nga të dyja palët të mos rimbursohen.

2. Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sugjerohet që:

a. Të përcaktohet në cilin moment fillon detyrimi ligjor për kryerjen e pagesës nga thesari; pra, kur fillon afati 5 ditor; Aktualisht, ka raste kur administrata tatimore ka njoftuar tatimpaguesin për shumën e aprovuar, por nga ana tjetër nuk ka dërguar Urdhër Pagesën në thesar, duke sjellë një ngërç që nuk rregullohet nga ky ndryshim.

b. Të specifikohet që, si kontrolli ashtu dhe pagesa kryhen në total brenda afatit 60-ditor apo 30-ditor ;

c. Të ndryshohet fjalia e fundit e paragrafit 1, duke specifikuar se «nëse nuk kryhet rimbursimi brenda afatit, pavarësisht se është bërë apo jo kontroll, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim». Vetëm në këtë mënyrë do të kemi një afat rimbursimi efektiv. Përndryshe, nëse do të presim që të kryhet kontrolli, pra të miratohet shuma e TVSH-së dhe pastaj të fillojë e drejta e tatimpaguesit për mospagesë, vendosja e afatit 60-ditor apo 30-ditor bëhet jo-efektiv dhe një rregull që anashkalohet lehtëzi nga administrata tatimore.

3. Në Ligjin nr. 61/2012, datë 24/05/2012 “Për Akcizën në Shqipëri” dhe «Taksat Kombëtare», në lidhje me taksën e rëndë të Akcizës dhe Karbonit për lëndë djegëse të ngurta (p.sh. Koks, Naftë):

Për shkak të ndryshimeve të fundit gjatë vitit 2012 në ligjin «Për akcizat» dhe «Taksat kombëtare», Shqipëria aktualisht vendosi taksa indirekte për lëndë djegëse të ngurta në shumën prej 5 lekë/kg, pra 2 lekë/kg për akcizën dhe 3 lekë/kg për karbonin. Këto taksa, të cilat kapin vlerën e 5.000 lekë/ton për koks naftë, rrisin çmimin e importit të lëndëve djegëse me 45% - 50%. Një rritje e tillë përkthehet në një barrë të konsiderueshme në strukturën e kostos prej rreth 4 milion euro në vit, duke pasur një efekt ~ 2.5 – 3 euro kosto shtesë për ton të produktit final, në varësi nga lloji i çimentos së prodhuar.

Në tregjet ndërkombëtare të tregtisë ky handikap në kosto është i rëndësishëm dhe nëse nuk eliminohet, mund të shkatërrojë kapacitetin e eksportit tonë shumë shpejt. ANTEA eksporton rreth 40% të prodhimit të saj vjetor, duke sjellë mbi 19 milion euro në vit nga eksportet. Kjo ecuri jashtëzakonisht pozitive e ANTEA-s është e vështirë të jetë e qëndrueshme në të ardhmen, për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate portuale në Durrës, për të akomoduar anije më të mëdha, si dhe për shkak të vendosjes së taksave të larta të karbonit dhe të akcizës mbi lëndët djegëse të ngurta, gjë që shkakton që eksporti i çimentos jashtë Shqipërisë të jetë një ushtrim shumë i vështirë. Kjo situatë për një vend si Shqipëria, me një defiçit kronik dhe të theksuar në tregtinë dhe në llogarinë rrjedhëse si përqindje e PBB-së, nuk mund të jetë e qëndrueshme në terma afatgjatë.

As BE-ja, dhe as vendet fqinje (me përjashtim të një takse të vogël në Kosovë) nuk aplikojnë taksa indirekte mbi lëndët djegëse që përdoren nga industria. Produktet e energjisë dhe energjia elektrike, në vendet e BE-së, taksohen vetëm kur ato përdoren si lëndë djegëse për motorë apo për ngrohje dhe jo kur përdoren si lëndë e parë djegëse në procesin e prodhimit, ose për qëllime të reduktimit kimik ose në procese elektrolitike dhe metalurgjike. (Direktiva e BE-së 2003/96/KE, e datës 27 tetor 2003, e cila ristrukturon kuadrin ligjor të Komunitetit për taksimin e produkteve të energjisë dhe energjinë elektrike).

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia apo Mali i Zi, aplikojnë taksë zero mbi importin e lëndëve djegëse të ngurta që përdoren nga industria. Edhe taksa 10% që aplikon Kosova për lëndët djegëse të ngurta është vetëm rreth 35% e taksave përkatëse indirekte që aplikohen për lëndët djegëse në Shqipëri. Sa më lart, taksa mbi akcizën si dhe taksa mbi karbonin, të cilat janë taksa indirekte, vendosen zakonisht në produktin përfundimtar dhe si të tilla mbulojnë nga konsumatori përfundimtar. Mënyra sesi taksa të tilla indirekte vendosen në Shqipëri, ato bëhen barrë për produktin e ndërmjetëm, duke ndikuar kështu tek prodhuesi dhe jo tek konsumatori final.

Lidhur me barrën financiare të konsiderueshme dhe sa i përket Akcizës, edhe pse Ligji 61/2012, datë 24/05/2012 “Për Akcizën në Shqipëri” dhe VKM 612, datë 24/05/2012, parashikon rimbursimin e akcizës për një periudhë të kufizuar prej 5 vjet, shoqëria ka hasur shumë vështirësi, të cilat kanë ndikuar në moskompensimin për të gjithë periudhën 2012-2014.

Ndaj, sugjerohet për sa më sipër, si dhe duke marrë parasysh në të njëjtën kohë kontributin e rëndësishëm të këtyre taksave në buxhetin publik, një zgjidhje alternative do të ishte zëvendësimi i taksave të tilla me TVSH-në ekuivalente apo taksa të tjera të zbatueshme në shitjen e produktit final (çimento) apo heqjen e taksës ekuivalente të akcizës dhe të karbonit në masën e zbatueshme për eksportet e kryera nga prodhuesi vendas, si dhe aplikimin në import të një takse doganore ekuivalente.

Së dyti, për periudhën e përdorimit të humbjeve tatimore komenti është që një nga qëllimet kryesore të qeverisë shqiptare është tërheqja e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) për kryerjen e investimeve Greenfield. Duke pasur parasysh natyrën dhe madhësinë e investimeve të tilla Greenfield, duhen zakonisht 3-5 vjet para se këto investime të fillojnë të prodhojnë fitime. Në disa raste, për shkak të kushteve të tregut, kjo

periudhë mund të jetë edhe më e gjatë. Në rrethana të tilla, këto shoqëri kanë grumbulluar humbje të cilat do të përdoren ndaj fitimit në të ardhmen.

Legjislacioni shqiptar, si Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, parashikon se humbjet tatimore mund të barten dhe të përdoren për një periudhë prej jo më shumë se 3 vjet.

Në lidhje me argumentin e lartpërmendur, në kohën kur Shoqëri të tilla fillojnë të prodhojnë fitime, si dhe duke marrë parasysh kushtet aktuale ekonomike të ngrira, është e qartë se dispozita përkatëse e legjislacionit shqiptar nuk i shërben qëllimit të krijimit të një mjedisi tërheqës për të tilla investime Greenfield. Ndryshe, vendet fqinje si Greqia, Bullgaria, Serbia, Turqia, u japin shoqërive një periudhë minimale 5 vjet, për të shfrytëzuar humbjet tatimore.

Për më tepër, vende të BE-së, si Italia, u japin Shoqërive një periudhë të pacaktuar për të shfrytëzuar humbjet tatimore të krijuara gjatë 3 viteve të tyre të para të investimeve.

Ndaj, sugjerohet që për këtë qëllim, si dhe duke synuar krijimin e një mjedisi tërheqës për investimet e huaja Greenfield, rekomandohet që periudha 3 vjet, përcaktuar në Ligjin “Mbi të ardhurat nga tatimet”, të zgjatet minimalisht me 10 vjet.

4. Ndryshim i taksës së qarkullimit për benzinën dhe gazoilin nga 17 lekë/litër në 27 lekë/litër,

Së pari, sugjerohet që në rregullimet e bëra në këtë ligj të përfshihet dhe përjashtimi nga taksa e qarkullimit e karburantit, që nuk përdoret për mjete transporti në infrastrukturë rrugore.

Taksa e qarkullimit mblidhet në import ose në prodhimin brenda vendit të benzinës dhe gazoilit, duke injoruar tërësisht faktin që këto produkte janë lëndë energjetike me përdorim më të gjerë sesa mjetet e transportit.

Konkretisht, ato përdoren gjerësisht si prodhues energjie në gjeneratorë apo dhe sonda të shpimit në industrinë e nxjerrjes së naftës. Meqenëse këto produkte energjetike përdoren për djegie, në mënyrë të llogjikshme paguajnë taksën e karbonit, por nuk duhet të paguajnë taksë për një shërbim të cilin nuk e marrin (pra, për infrastrukturën rrugore). Vetë përkufizimi i taksës i dhënë në ligjin për procedurat tatimore parashikon se:

“Taksë”, është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pra, për sa kohë përdoruesit e këtyre karburanteve nuk ushtrojnë një të drejtë publike apo përfitojnë një shërbim (nuk përdorin infrastrukturën rrugore sa kohë që përdorimi i gazoilit bëhet për përdorim industrial) nuk duhet ta paguajnë këtë taksë.

Së dyti, karburantet aktualisht taten me akcizë 37 lekë, taksë qarkullimi 17 lekë dhe taksë karboni 3 lekë, pra në total 57 lekë për litër. Pra, edhe pa këtë propozim të fundit të qeverisë, Shqipëria ka një nivel taksimi më të lartë sesa minimumi i kërkuar nga BE-ja në

vlerë absolute. Nëse do t'i referohemi këtij niveli, duke marrë në konsideratë edhe nivelin e të ardhurave për frymë, rezulton se Shqipëria ka një nga barrat më të rënda të taksimit të karburanteve. Edhe pretendimi që meqenëse aktualisht ka një ulje të çmimit në tregun botëror dhe kjo rritje nuk do të ketë efekt në çmimin me pakicë është spekulativ. Për këtë arsye, sugjerojmë rishikimin e kësaj mase dhe mosndryshimin e nivelit të taksës së qarkullimit.

Sugjerim për ndryshim të ligjit “Për taksat kombëtare” lidhur me aplikimin e taksës së karbonit dhe qarkullimit mbi solarin dhe lëndë të përdorura në procese teknologjike, jo si lëndë djegëse apo karburant për mjete të transportit rrugor.

Aktualisht, ligji “Për taksat kombëtare” parashikon taksën e karbonit për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin, koks naftë. Kjo taksë është në masën 3 lekë për solarin, i cili përdoret gjerësisht në sektorin hidrokarbur si “diluent” (hollues). Pra, solari injektohet në pus apo përzihet me naftën bruto, por nuk përdoret për djegie. I referohemi këtu Gazoil 1000 ppm, për të cilin nuk lejohet gjithashtu importi në Shqipëri për përdorim si lëndë djegëse/karburant për mjete të transportit.

Eksperiencat e huaja në vende të tjera tregojnë se në rastet kur lënda djegëse nuk digjet, përdoruesit e tyre marrin certifikatë përjashtimi ose rimbursohen për taksën e paguar. Për shembull, në Kanada, mospërdorimi si burim energjie i lëndës djegëse përjashtohet nga taksa (lënda djegëse që nuk është djegur, por është përdorur në operacionet nëntokë në pus).

Taksa e karbonit është taksë mjedisore e vendosur mbi përmbajtjen e karbonit të lëndës djegëse, që emetohet si dioksid karboni kur digjet.

Taksa e qarkullimit mbledhet vetëm për ato lëndë, të cilat përdoren si lëndë djegëse për mjete të transportit dhe vlera aktuale 17 lekë për litër, e cila parashikohet të rritet në 27 lekë duhet të mbledhet vetëm për rastet e karburanteve, të cilat përdoren në automjete, objekt i përdorimit të sistemit të transportit rrugor në Shqipëri.

Siç theksuam më lart, përkufizimi i taksës konsiston në pagesë të taksapaguesit për një shërbim publik të kryer nga shteti; për rrjedhojë, taksa do t'i korrespondonte domosdoshmërisht ofrimit të këtyre shërbimeve publike.

Në këto kushte, përdorimi i solarit/holluesit në industrinë e hidrokarbureve në proceset teknologjike duhet të konsiderohet i përjashtuar nga taksa e karbonit dhe ajo e qarkullimit.

5. Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar,

Fillimisht, nënvizohet se kontributet në fond nuk janë të ardhura për individin, por shpenzime, si të tilla nuk mund të përfshihen në të ardhurat e patatueshme. Por, duke qenë se qëllimi është që punëdhënësi të mos mbajë nga të ardhurat nga punësimi atë pjesë të kontributeve të përballuara nga punëmarrësi, sugjerojmë që ky ndryshim të bëhet në nenin 8, pika 1, ku rregullohen të ardhurat nga pagat dhe marrëdhëniet nga punësimi.

Në mënyrë që të ketë një rregullim përfundimtar, ndryshimet në ligjin «Për tatimin mbi të ardhurat», duhet të përfshijnë të gjitha dispozitat tatimore të përcaktuara dhënë në ligjin 10197, datë 10.12.2009 «Për fondet e pensionit vullnetar».

Gjithashtu, sugjerohet që neni 13/3 «Shpenzimet e zbritshme», në pikën 1, gërma (a) të mos shfuqizohet. Pra, kontributet të mbeten shpenzim i zbritshëm për rastet kur këto kontribute nuk janë paguar nëpërmjet punëdhënësit, por drejtpërdrejt nga individët (jashtë skemës së punësimit).

6. Rritja e tatimit mbi të ardhurat personale për dividendë, interesa, qira, të ardhura nga transferimi i pronësisë mbi pasurinë e paluajshme etj nga 10% në 15%,

Ky ndryshim është i diskutueshëm, sepse vë Shqipërinë në një pozitë të vështirë konkurruese me vendet e rajonit. Në fakt, ekziston rreziku që shoqëri të ndryshme të zhvendosin aktivitetin e tyre në vende të ndryshme të rajonit, ku norma e taksimit është më e ulët.

Ndër të tjera, nuk ka incentiva për rritjen e formalizimit dhe për pasojë rritet barra mbi tatimpaguesit e rregullt.

Shqetësues është diskriminimi që i krijohet personave në shoqëri. Fare mirë në këtë pikë mund të krijohet një mundësi për evazion fiskal në fushën e profesioneve të lira.

7. Miratimi i akteve nënligjore për firot dhe skarcot,

Sugjerohet që përcaktimi i firove dhe skarcove të bëhet me ngritjen e një komisioni të posaçëm, i cili do të jetë i angazhuar në vijimësi për rishqyrtimin e këtyre normave. Ekzistenca e firove dhe normave është në nivele të ndryshme jo vetëm për industri të ndryshme, por edhe për aktivitete të të njëjtës industri. Gjithashtu, përcaktimi duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e specializuara në fushat përkatëse, psh AKBN-ja, etj.

8. Në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” të ndryshuar,

Neni 22 siç është aktualisht e rregullon amortizimin për qëllime tatimore në bazë grupi. Kur amortizimi llogaritet në bazë grupi, aktivet nuk identifikohen në mënyrë individuale / të veçantë. Ky është ndryshimi nga amortizimi për ndërtesat, konstruksionet e tjera përmendur në pikën 3 të këtij neni.

Po ashtu, pikat 6 dhe 7 të po këtij neni kanë rregullimet se si llogaritet amortizimi në bazë grupi, duke përfshirë dhe rastet kur vlera e grupit të jetë më e vogël se 5 mijë lekë. Nga ana tjetër, në praktikë si nga tatimpaguesit ashtu dhe nga administrata tatimore, amortizimi llogaritet në mënyrë individuale, dhe për më tepër, kërkohet gjithnjë shitja mbi vlerën e mbetur për qëllime tatimore.

Ndërhyrja vetëm me një paragraf, do të shtonte konfuzionin në lidhje me amortizimin e aktiveve dhe në këtë mënyrë siç është shkruar do binte në kundërshtim me pikat e tjera të nenit ekzistues.

Sugjerohet një ndërhyrje më e qartë në këtë nen, së pari duke aplikuar edhe për qëllime tatimore amortizimin në bazë lineare, mbajtjen individuale të të gjitha llojeve të aktiveve (sistemet informatike e mundësojnë tashmë që tatimpaguesit të mbajnë në mënyrë të detajuar këtë aktiv) si dhe shtimin e grupeve dhe normave të ndryshme të amortizimit.

Parimi është që të bëhet në bazë aseti dhe 10% e kostos fillestare.

9. Në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” të ndryshuar, rritja e tatimit të mbajtur në burim në masën 15%,

Përbën një kosto shtesë për kompanite vendase që përfitojnë shërbimet e ofruara nga tatimpagues jo-rezidentë. Kjo, për faktin se e gjithë barra fiskale e rritur do të kalojë tek shoqëritë rezidente, të cilat do të duhet të paguajnë më shumë në vitin 2015, për të përfituar të njëjtin shërbim.

Aq më tepër kur akoma nuk janë parë efektet nga rritja e tatimit mbi fitimin nga 10% në 15%.

Konkretisht, tatimi që duhet të paguajë një investitor i huaj në Shqipëri nga 19% e fitimit është rritur në rreth 28%, duke ulur ndjeshëm konkurrueshmërinë në rajon dhe më gjerë. Pavarësisht reformave të ndërmarra, ky kapërcim/ritje nuk mund të zbutet nga përmirësimi i klimës së biznesit.

Nga ana tjetër, niveli i informalitetit në vend do të bëjë që shoqëritë që vijnë nga BE-ja apo nga vendet e Amerikës së Veriut, të jenë edhe më pak konkurrese ndaj shoqërive shqiptare, gati gjysma e të cilave mbetet informale. Industritë të cilat qeveria i ka vënë si prioritet (fason apo call center) janë shumë të ndjeshme në lidhje me kostot e tatimeve në vend, për më tepër e kanë shumë të lehtë transferimin në një vend tjetër.

Për sa më sipër e shikojmë këtë masë me ndikime negative në ekonominë e vendit.

10. Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Përdorimi i çmimeve të referencës bie në kundërshtim me pritshmëritë e biznesit për reduktim të rolit të tyre. Nga qeveria është marrë angazhim eliminimi i çmimit të referencës nga përdorimi edhe në doganë dhe nga ana tjetër, rifuten për përdorim nga administrata tatimore. Eksperiencia e deritanishme ka treguar se çmimet e referencës janë keqpërdorur nga inspektorët tatimore dhe kanë përkeqësuar treguesit e të bërit biznes në Shqipëri.

11. Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Sugjerohet ulja në të njëjtën masë edhe për subjektet e regjistruara për tatim fitimi. Gjoha është aktualisht 500 mijë Lekë dhe në praktikë është përdorur më shumë si mjet presioni për korrupsion sesa si shtysë për formalizimin e punonjësve.

12. Lidhur me gjobat për mospërdorimin e kasës fiskale,

Parimisht, rritja e masës së gjobës jo domosdoshmërisht çon në uljen e informalitetit. Ky është edhe rasti i përmendur në komentin më sipër. Përkundrazi, gjoba shumë e lartë mund të mos prekë formalizimin e ekonomisë, por përkundrazi të rrisë shanset për korrupsion. Rrjedhimisht, mendojmë se shuma e gjobave duhet të jetë në proporcion me shkeljen dhe të ushtrohet kontroll nga administrata tatimore për respektimin e legjislacionit, por jo me qëllim rritjen e shumës së gjobave të arkëtuara.

Mendohet se ndryshimet e fundit të bëra në ligjin për akcizat (ku u ulën gjobat minimale) për shkak se në shumë raste, shkelja nuk i përgjigjej masës së gjobës, është një tregues që duhet të merret në konsideratë dhe të trajtohet njëjloj nga ministria edhe për detyrimet tatimore.

13. Në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” të ndryshuar,

Prezumohet se qëllimi i ndryshimit është rregullimi i terminologjisë dhe përshtatja me ndryshimet në mënyrën e taksimit të biznesit të vogël.

Megjithatë, një problem që është hasur në praktikë është mënyra e deklarimit të të ardhurave individuale të personave të vetëpunësuar, të cilët kanë një qarkullim më të madh se 8 milion lekë.

Këta individë paguajnë tatim mbi fitimin në masën 15% mbi rezultatin e pasqyrave financiare. Për sa më sipër, sugjerohet që dispozita e mësipërme të ndryshohet, duke përcaktuar shprehimisht se të ardhurat e realizuara si subjekt i tatimit mbi fitimin nuk deklarohen në deklaratën individuale, ose të ndryshohet dispozita si më poshtë, duke përfshirë këto lloj tatimpaguesish:

“Të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët dhe të fitimit të tatueshëm nga zhvillimi i veprimtarisë së biznesit si i vetëpunësuar (person fizik) sipas Deklaratës së Tatimit të Thjeshtuar mbi fitimin ose Formularit të Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin, cilido qoftë rasti”.

Në këtë mënyrë vendoset barazi mbi mënyrën e deklarimit të të ardhurave individuale dhe kjo deklaratë përfshin të gjitha kategoritë e individëve që krijojnë të ardhura, pavarësisht se si janë tatuar nga pikëpamja e tatimit mbi fitimin (standard apo i thjeshtuar).

14. Në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” të ndryshuar,

Me shfuqizimin e dy prej katër gërmave të kësaj pike, shpenzimet e zbritshme për individin reduktohen në nivel tërësisht të papërfillshëm. Duke patur parasysh se prioritet i Qeverisë është lufta kundër informalitetit, do të ishte me vend shtimi i shpenzimeve të zbritshme si një mënyrë që do të bënte individët e interesuar të kërkonin kuponin tatimor dhe formalizim të shpenzimeve të kryera nga individët. Po ashtu, është e pajustificueshme që të kërkohej tatim mbi taksën e paguar në rastin e taksës së ndërtesës (meqë nuk njihet si shpenzim) dhe kjo do të sillte rritje të informalitetit edhe në këtë fushë.

15. Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sugjerohet që ndryshimi të ndodhë në kahun tjetër, pra përkufizimi në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshojë sipas këtij ligji. Ky ndryshim do të ishte në të njëjtën linjë dhe me modelin e OECD-së për marrëveshjet e eliminimit të dyfishtë. Përdorimi i 365 ditëve apo dhe 12 muajve është një rregullim që po përshtatet dhe nga vende të tjera dhe mendojme se do t’i rezistonte më shumë kohës.

16. Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sugjerohet që Ministria e Financave të japë informacion lidhur me vlerën që mendohet se do të kalojë në favor të DPT-së sipas këtij neni, ndarjen e parashikuar ndërmjet shpenzimeve për investime dhe shpenzimeve për bonuse si dhe numrin e punonjësve të DPT-së, në mënyrë që të mund të komentojmë në lidhje me këtë pikë.

17. Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kundërshtohet vendosja e një mase të tillë. Legjislacioni tatimor aktualisht e ngarkon tatimpaguesin me shumë detyrime, që kanë të bëjnë me mbledhjen e detyrimeve tatimore nga të tretët.

Format e të bërit biznes sot në Shqipëri janë të shumëllojshme, që nga shoqëritë që kanë departamente për prokurim deri tek shoqëritë që nuk kanë fare funksione të tilla.

Një masë e tillë është një barrë e panevojshme për biznesin, barrë e cila i takon ta mbajë administrata tatimore.

Detyrimi i tatimpaguesit është të paguajë tatimet që i takojnë atij dhe jo të kontrollojë tatimpagues të tjerë. Për më tepër, me deklarin *on-line* që në datë 5 të çdo muaji, administrata tatimore ka të gjithë informacionin e nevojshëm që të identifikojë të gjithë tatimpaguesit në status pasiv që kanë lëshuar faturë tatimore. Nëse nuk shërben ky deklarin *on-line* për një kontroll të tillë, atëherë qenka tërësisht i panevojshëm.

Gjithashtu, si do të verifikohet që një subjekt i caktuar ka qenë në listën e subjekteve pasive në një datë disa muaj më parë?

18. Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Mendohet se detyrimi për të dhënë informacion sipas këtij neni është shumë i gjerë. Duhet që ligji të përcaktojë rastet kur jepet dhe çfarë informacioni jepet.

Detyrimi i palëve të treta për të dhënë informacion nuk mund të jetë i pakufizuar. Një shembull i qartë i këtij parimi është përmbajtja aktuale e nenit 62.

19. Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sugjerimi është se,

Ashtu siç ka treguar praktika në këto vite, fillimi i procedurave të falimentimit nga ana e administratës tatimore nuk ka qenë i suksesshëm. Kjo, për arsyen se vetë ligji i falimentimit e lidh hapjen e procesit me aftësinë paguese. Është e qartë që në status pasiv mund të jenë tatimpagues në pritje të rifillimit të aktivitetit, por që nuk kanë probleme me aftësinë paguese. Për këto raste, gjykata është e detyruar të mos e rifillojë procedurën (administrata tatimore do të duhet të paguajë ekspertin që do të bëjë vlerësimin e aftësisë paguese).

LETRA DHE PROPOZIMET TEKNIKE PËR PAKETËN FISKALE 2015

Dërguar më 8 shtator dhe ridërguar më 7 nëntor 2014

Dhoma Amerikane e Tregtisë falenderon Ministrinë e Financave nëpërmjet kësaj letre për ndihmën dhe gadishmërinë për të bashkëpunuar për të gjitha çështjet e përbashkëta që fokusohen në zhvillimin e biznesit, mbrojtjen e investimeve të huaja në vend dhe ruajtjen e një klime të mirë e të qëndrueshme.

Dhoma Amerikane e Tregtisë e trajtoi me mjaft seriozitet kërkesën e Ministrisë së Financave, për të sjellë komente dhe sugjerime në lidhje me Paketën Fiskale 2015. Ne kemi marrë mendimin e anëtarëve tanë dhe e kemi filtruar nën kujdesin e ekspertëve më të mirë të fushës, për të sjellë një mendim profesional për ndryshimet që duhet të pësojë Paketa Fiskale 2015, në mënyrë që ajo t'i shërbejë jo vetëm biznesit, por dhe zhvillimit të ekonomisë dhe rritjes së investimeve të huaja në vend.

Ne ndihemi të privilegjuar të kemi mundësinë t'ju sjellim nëpërmjet kësaj letre komentet tona mbi mënyrën se si ne e shohim përmirësimin e legjislacionit fiskal.

Në këtë kuadër, anëtarët e Dhomës inkurajojnë marrjen e masave nga qeveria dhe administrata tatimore për uljen e evazionit fiskal dhe formalizimin e ekonomisë. Afërsisht rreth 50 përqind e ekonomisë shqiptare është informale dhe nuk paguan fare taksat ose paguan më pak. Synimi i qeverisë për të mbledhur më shumë të ardhura nga tatimet dhe taksat mund të realizohet vetëm nëse kjo pjesë e ekonomisë do të formalizohet dhe do të paguajë tatimet që i takojnë sipas legjislacionit në fuqi.

Nga ana tjetër, zhvillimet ekonomike dhe fiskale në vend e kanë bërë të nevojshme që të merren në konsideratë jo vetëm masa shtrënguese për bizneset me qëllim formalizimin e ekonomisë, por edhe ofrimi i incentivave për konsumatorët nëpërmjet tërheqjes së kuponit tatimor dhe mundësisë për njohjen e disa shpenzimeve të zbritshme kur ato justifikohen me këto kupona tatimorë. Kjo lëvizje do t'i stimulojë të gjithë konsumatorët që të marrin kuponin tatimor për çdo shpenzim dhe do të ndihmojë në uljen e evazionit fiskal.

Si rrjedhojë e zgjerimit të bazës së tatimpaguesve nëpërmjet mënyrave dhe mekanizmave të lartpërmendur, do të ishte e nevojshme që të rishikohej niveli i tatimit të fitimit dhe të ardhurave personale në mënyrë që ato të bëhen të konkurrueshme në rajon dhe që do t'i jepte mundësi më të mëdha biznesit për rritjen e investimeve dhe për pasojë, nivelin e të ardhurave në buxhet.

Anëtarët tanë u shprehën gjithashtu se detyrimi ligjor për parapagimin e tatimit dhe të kamatëvonesave përpara apelimit administrativ dhe gjyqësor është një kërkesë që rëndon biznesin dhe në një moment të caktuar mund të nxisë abuzimin e administratës tatimore për arketime detyrimesh tatimore në një afat të shkurtër. Siç e kemi përmendur edhe më parë, qëndrimi i Dhomës Amerikane është që procedura e apelimit të pezullojë efektet e njoftimit vlerësimit tatimor dhe ky të bëhet i zbatueshëm vetëm pas marrjes së një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Anëtarët e Dhomës Amerikane kanë sjellë edhe shumë propozime të tjera që mund të përfshihen në Paketën Fiskale 2015, duke u nisur nga profili i aktivitetit që përfaqësojnë. Ne besojmë se kërkesat tona do të shikohen me sy profesional dhe nisur nga bashkëpunimi i suksesshëm që kemi patur, shpresojmë se disa nga kërkesat themelore që prekin edhe politikën fiskale do të merren në konsideratë.

Ju lutem gjeni si më poshtë listën e komenteve dhe sugjerimeve që anëtarët e Dhomës Amerikane kanë për Paketën Fiskale 2015.

1. Marrja e masave nga qeveria dhe administrata tatimore për uljen e evazionit fiskal dhe formalizimin e ekonomisë, jo vetëm nëpërmjet fushatave informuese, por edhe nxjerrjen dhe zbatimin e masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi. Në këtë kuadër, sugjerohet të gjendet një mënyrë për mbledhjen e kuponave tatimorë nga konsumatorët, në mënyrë që më pas të njihen si shpenzime të zbritshme apo të ofrohen incentiva të tjerë fiskalë. Kjo do të ndihmojë formalizimin e ekonomisë dhe konkurrencën e ndershme. Është koha që bizneset informale të vihen përpara përgjegjësisë.
2. Pagesa e detyrimit dhe e interesave të vendosur nga organet tatimore të kryhet vetëm pas dhënies së një vendimi të formës së prerë (nga drejtoria e apelimit apo gjykata), pasi në mjaft raste edhe vendosja e një garancie për ndjekjen e procedurës së apelimit rezulton e pamundur nga bizneset dhe nga ana tjetër mund të nxisë abuzimin e administratës tatimore për arkëtime detyrimesh tatimore në një afat të shkurtër. Në kushtet e funksionimit të rregullt të gjykatës administrative (me shkurtimin e kohës së nevojshme për çështjet gjyqësore administrative), është shumë më e lehtë marrja në konsideratë e kësaj kërkesë.
3. Rishikimi i normës së tatimit mbi të ardhurat personale nga paga në mënyrë që të kemi një trajtim të barabartë të të ardhurave personale, pavarësisht nëse ato janë të krijuara nga puna, aktiviteti i biznesit apo kapitali. Sugjerohet një zbutje e dallimeve mes këtyre llojeve të të ardhurave, në mënyrë që të ardhurat personale të tatonen në të njëjtat nivele, pavarësisht nga natyra e tyre. Për këtë qëllim, të ardhurave personale nga paga mund t'u njihen disa incentiva si shpenzime të zbritshme.
4. Rishikim dhe ulje e normës së tatimit mbi fitimin.
 - a. Përsa më sipër do të nxiste rritjen ekonomike nëpërmjet riinvestimit të të ardhurave më të larta “në duart” e bizneseve;
 - b. Do të ulte shkallën e evazionit fiskal, e cila qartësisht dhe lehtësisht evidentohet në treg në shumë sektorë të ekonomisë;
 - c. Do të rriste interesin për FDI-në, duke e barazuar ose sjellë në nivele të ngjashme me vendet e rajonit;
5. Mosaplikimi i tatimit mbi fitimin i kompanive (rimbursimi i tatimit mbi fitimin) në rastin kur fitimet vjetore të tyre nuk shpërndahen në formë dividendi, por riinvestohen nga kompania.
 - a. Kjo do të sillte rritjen e interesit nga biznesi për të riinvestuar të ardhurat vjetore, duke rritur në mënyrë të drejtpërdrejtë investimet në ekonomi, vende të reja pune, ulje të informalitetit etj.
 - b. Nuk do të kishte kosto të lartë në buxhetin e shtetit në raport me benefitet në periudhën afatmesme.
 - c. Forma të ngjashme janë aplikuar me shumë sukses nga vendet e rajonit.
6. Rritja e periudhës kohore për mbartjen fiskale të humbjeve nga 3 vjet që është aktualisht në 5 ose 7 vjet. Kjo gjë do të përmirësonte situatën, sidomos të atyre tatimpaguesve që kryejnë investime të konsiderueshme dhe është praktikë e njohur në botë dhe aplikuar me sukses edhe në vendet e rajonit.

7. Nëse kërkesa e propozuar në pikën 2 nuk merret në konsideratë, sugjerohet që:
- a. të miratohet një Udhëzim, i cili do të përfshijë dhe detajojë elementet e garancisë.
 - b. dhe garancia e vendosur nga ana e subjekteve të mos jetë vetëm bankare, por të njihet edhe garancia e lëshuar nga shoqëritë e sigurimit të licensuara në vend. Kjo do t'i lejonte biznesit përdorimin e likuiditeteve të nevojshme pa qenë nevoja e bllokimit në bankë.
8. ~~Sugjerojmë që Drejtoria e Apelit të Tatimit të bëhet një drejtori e veçantë brenda Ministrisë së Financave, me qëllim rritjen e pavarësisë së kësaj Drejtorie. Aktualisht, vetëm Drejtori i Drejtorisë është i varur nga Ministria e Financave, ndërkohë që inspektorët emërohen dhe largohen nga detyra me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. (Ky koment është marrë në konsideratë)~~
9. Struktura aktuale e Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesve, siguron pjesërisht pavarësinë e autoritetit të këtij funksioni. Autoriteti i Avokatit të Tatimpaguesve është i varur organikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (pjesë e organigramës së DPT-së).

Një drejtori e Avokatit të Tatimpaguesve, e pavarur, vetëm nën varësinë e Ministrisë së Financave, do t'i japë autoritet më të plotë funksional, për mbajtjen e qëndrueshme të një pozicioni të paanshëm, gjatë punës së saj.

Gjithashtu, sugjerojmë që të zgjerohen kompetencat e Avokatit të Tatimpaguesve. Konkretisht, sugjerojmë që pas marrjes së projekt raport kontrollit, observacionet e tatimpaguesit, që kanë lidhje me kërkesa procedurale t'i dërgohen njëkohësisht edhe Avokatit të Tatimpaguesve dhe ky i fundit të shprehet brenda një periudhe kohore të caktuar. Drejtoria Rajonale të marrë në konsideratë sugjerimet e Avokatit dhe nëse gjykon që kjo nuk është e mundur, të arsyetojë për rrëzimin e pretendimeve të tatimpaguesit dhe sugjerimeve të Avokatit të Tatimpaguesve.

Së dyti, procedurat e rikontrollit të autorizohen me pëlqimin e Avokatit të Tatimpaguesve. Aktualisht, këto procedura vendosen vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila nuk njofton tatimpaguesin dhe as arsyeton në lidhje me urdhërin për rikontroll dhe arsyet e rikontrollit.

~~Sugjerohet të ndryshohet dispozita mbi amortizimin e aktiveve afatgjata të biznesit, duke iu përshtatur zhvillimeve të reja ekonomike dhe teknologjike. Metoda aktuale (mbi vlerën e mbetur) nuk reflekton me realitetin ekonomik, duke sjellë një shtrembërim edhe në aspektin e raportimit financiar. Sugjerimi ynë do të ishte aplikimi i metodës lineare në bazë të vlerës historike (pa marrë parasysh amortizimin kontabël) në normat e mëposhtme: (Ky koment është marrë pjesërisht në konsideratë)~~

- Për ndërtesat 5%
- Për linjat teknologjike dhe makineritë 10%
- Për pajisje informatike 33.3%
- Për të tjerat 20%

Ky ndryshim do të ndikonte në cilësinë e raportimit kontabël, duke e çliruar këtë të fundit nga ndikimet që ka legjislacioni tatimor mbi të. Po ashtu, normat e propozuara janë më afër realitetit teknologjik dhe do të ndikojnë në rritjen e investimeve në aktive afatgjata.

10. Sugjerohet që në Ligjin nr. 9975, datë 28/07/2008 “Për Taksat Kombëtare”, taksa për ambalazhet njëpërdorimshe të prodhuara me material të ricikluar nga mbetjet plastike të gjeneruara në vend, të jetë 1 (një) lekë/kg, një vlerë kjo simbolike dhe që mund të përdoret për efekt statistikor.

11. Akciza [pulla fiskale pije dhe duhan të grirë (*jo cigare*)]. Do të sugjerohej që pulla fiskale të vendosej në magazinën doganore në Shqipëri, për arsyt e mëposhtme:

- a. Kosto e punës për vendosjen e pullave fiskale tek ne është më e ulët.
- b. Hapja e vendeve të reja të punës.
- c. Vendosja e pullës fiskale tek furnitori pengon eksportin, pasi pulla jonë fiskale nuk njihet jashtë vendit dhe produkti duhet zhveshur prej saj. Kjo na çon në humbjen e ekskluziviteteve për Ballkanin.

Aktualisht, vendosja e pullave fiskale për pijet dhe duhanin e grirë është e detyrueshme që të bëhet tek furnitori. Mirëpo, duke qenë se në Evropë dhe me gjerë nuk vendosen pulla fiskale për pijet dhe duhanin e grirë, furnitorët tanë nuk kanë pajisje për t’i vendosur ato. Pra, për ta është një proces jashtë serisë së proceseve normale të tyre. Vetë furnitorët gjejnë magazina doganore në vendet e tyre, apo Itali dhe bëjnë atje vendosjen e pullave fiskale me dorë. Kjo gjë rrit koston, pasi puna me dorë e punonjësve që merren me këtë proces kushton. Por gjithashtu, duke qenë se malli del nga paketimi, pasi pulloset copë për copë, ekziston mundësia e dëmtimit apo vjedhjes së mallit në këto pika tranzite.

12. Mendojmë se data 5 e deklarimit të librave të Blerjeve dhe të Shitjeve është shumë e shkurtër dhe krijon vështirësi për shoqëritë. Kjo datë kaq e afërt nuk ka pasur ndonjë efekt në uljen e evazionit në lidhje me lëshimin e faturave fiktive të shitjes. Si rrjedhim, sugjerojmë që kjo datë të njehsohet me deklarimin e TVSH-së, pra edhe deklarimi i librave të Blerjeve dhe të Shitjeve të bëhet në të njëjtën datë me deklarimin e TVSH-së ose të bëhet pas 5 ditësh pune (jo në datën 5 të muajit), ose brenda datës 10, sepse është një kohë e pamjaftueshme në rastet kur fillimi i muajit koinçidon me fundjavën ose me festa zyrtare.

13. Me qëllim përmirësimin e konkurrueshmërisë së industrisë vendase si dhe rritjen e atraktivitetit të vendit për investimet e huaja direkte, sugjerohet anulimi i akcizës dhe taksës së karbonit mbi lëndët djegëse, në linjë me direktivat e BE-së (Direktiva e BE-së 2003/96/KE e datës 27 tetor 2003), e cila ristrukturon kuadrin ligjor të Komunitetit për taksimin e produkteve të energjisë dhe energjinë elektrike), në rastin kur ato nuk përdoren si lëndë djegëse për mjete motorike apo për ngrohje.

Nga ana tjetër, duke konsideruar kontributin e rëndësishëm të këtyre taksave në buxhetin publik, zgjidhje të tjera alternative mund të gjenden për të rivendosur konkurrencën e drejtë pa impakt në financat e shtetit si psh. rritja e TVSH-së së aplikueshme për produktet e çimentos dhe/ose aplikimi i një takse tjetër ekuivalente në shitjen e produktit final (çimento), ose anulimi i akcizës ekuivalente dhe taksës së karbonit për sasi të eksportuara nga prodhuesit vendas dhe aplikimi në import i një detyrimi doganor prej 2.5 – 3 euro/ton.

14. Në fund të nenit 59, të projektligjit për Procedurën Tatimore, të shtohet paragrafi:
“Ministria e Financave përcakton me udhëzim se cilat aktivitete do të përjashtohen nga detyrimi për të ndarë në vende të veçanta, të ndarë nga njeri - tjetri, shitjen me shumicë nga ajo me pakicë”.
- a. Arsytimi i disa prej këtyre përjashtimeve qëndron në faktin se numri i artikujve që tregtojnë është me mijëra artikuj. Xhiroja që bën një pikë shitjeje është në bazë të gjithë kësaj shumëllojshmërie, por xhiroja për artikull është shumë e vogël. Nevoja e popullsisë për këto artikuj gjithashtu është e kufizuar se nuk janë mjete të konsumit të përditshëm. Për këtë arsye, një biznes i këtij lloji nuk mund të përballojë dy pika shitje të ndryshme, një pakice dhe një shumice, sepse fitimi i pritshëm nuk e justifikon shpenzimin. Gjithashtu, këto lloj aktiviteteve kërkojnë personel të specializuar në çdo pikë tregtimi. Fakti që shitoret e këtyre aktiviteteve në Tiranë janë jo më shumë se pak dhjetra, e nganjëherë edhe më pak se dhjetë, ndërsa shitoret e ushqimoreve, detersiveve, fruta-perimeve, veshjeve, etj. janë me mijëra, tregon ndryshimin e madh që këto biznese kanë me njëri - tjetrin.
 - b. Një tregues tjetër për ne është mungesa e prodhimit në vend të këtyre mallrave. Kërkesa e kufizuar e tregut për artikull nuk justifikon ngritjen e industrisë prodhuese.
 - c. Në këto biznese trajtohen edhe disa artikuj të veçantë, në sasira shumë të vogla, që nuk mund të tregtohen nga një pikë pakice, prandaj edhe një konsumator final është i detyruar t'i drejtohet atyre pak pikave shumice që e disponojnë.